



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERJISË  
Sekretaria

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ .07.2023

**MBLEDHJA Nr. 40,**  
**Datë 27.07.2023, ora 12:00**  
**e Bordit të ERE-s**

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Enjte, datë 27.07.2023, ora 12:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 40 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së bordit të ERE-s më datë 19.07.2023.
2. Mbi kërkesën “G.S.K” shpk, për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 2 MW.
3. Mbi licencimin e shoqërisë “GLOBAL TECHNICAL MECHANICS” shpk në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën [erealb@ere.gov.al](mailto:erealb@ere.gov.al), jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**